

NJOFTIM

Për kandidatët që do të testohen për pozicionin e punës:

Specialist monitorimi Krujë

Drejtoria e Monitorimeve, Kontrollit dhe Inspektimeve

Procedura: LËVIZJE PARALELE NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe VKM-së nr.243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, levizjen paralele, periudhen e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), njofton se:

- **Z. Arjan Biçi** do të vazhdojë konkurimin në procedurën e lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive.

Konkurimi

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve), Rr.Reshit Çollaku, në datën **07.04.2023 ora 10:30**.

Kandidati do të vlerësohet nga **Komisioni i Brendshëm i ngritur në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- 40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnime dhe kualifikime në fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.
- 60 pikë** për intervistën e strukturuar me gojë.

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin **Specialist monitorimi Krujë**.

Në rast se dalin fitues me shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikes 13, Kreu IV të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, levizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar.

Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të njoftohet në datën **07.04.2023**.

Njoftimi do të publikohet: në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **13.04.2023**.

Vetem në rast se në fund të procedurës së lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive rezulton se ky pozicion është vakant si rezultat i mosparaqitjes apo mosshpalljes fitues të kandidatit pjesëmarrës, pozicioni do të jetë i vlefshëm për të vijuar nëpërmjet procedurës së "Pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive" !!!

Njesia Përgjegjëse / Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)